

L I G J
Nr.8480, datë 27.5.1999

**PËR FUNKSIONIMIN E ORGANEVE KOLEGJIALE TË ADMINISTRATËS
SHTETËRORE DHE ENTEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Përkufizime

Organe kolegjinale të administratës shtetërore dhe të enteve publike në kuptimin e këtij ligji, do të quhen të gjitha ato subjekte të së drejtës publike të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekzekutive vendimarrëse në mënyrë kolegjinale.

Me ent publik për qëllimet e këtij ligji do të kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike joshetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik.

Neni 2
Kryetari dhe sekretari

1. Çdo organ kolegjal ka një kryetar dhe një sekretar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

2. Kryetari i organit kolegjal, përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

3. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

4. Kryetari ose çdo anëtar tjetër i organit kolegjal ka të drejtë të bëjë ankime në gjykatë kundër vendimeve të marra nga ky organ dhe të kërkojë pezullimin e zbatimit të tij, kur çmon se vendimi është i kundërligjshëm.

Neni 3
Zëvendësimi i përkohshëm i kryetarit dhe sekretarit

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, kryetari dhe sekretari i çdo organi kolegjal zëvendësohen përkohësisht, përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga anëtari më i ri në detyrë, që të dy me të drejtë vote.

2. Në rastet kur anëtarët me të drejtë vote kanë shërbyer si anëtarë për një periudhë të njëjtë kohe, zëvendësimi i përkohshëm do të bëhet përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga ai më i ri në moshë.

Neni 4
Mbledhjet e rradhës

1. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të rradhës, përveç rasteve kur vetë organi ka vendosur ndryshe.
2. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar i të organit kolegjial, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.

Neni 5
Mbledhjet e jashtëzakonshme

Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren nga kryetari, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 6
Thirrja e mbledhjeve

1. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
2. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, të paktën 48 orë para datës së thirrjes të mbledhjes.
3. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

Neni 7
Rendi i ditës

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga anëtarët e organit kolegjial me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij organi. Kërkesa për ta futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen.
2. Rendi i ditës duhet t'i shpërndalet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.

Neni 8
Marrja e vendimeve

Organi kolegjial merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 9
Mbledhjet e hapura

1. Mbledhjet e organeve kolegjiale jo të zgjedhura nuk bëhen të hapura, përveç rasteve

kur ligji parashikon ndryshe.

2. Kur mbledhjet bëhen të hapura duhet njoftuar data, ora dhe vendi i mbledhjes, në mënyrë që të garantohet njoftimi i palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet të aktën 48 orë përpara datës së mbledhjes.

Neni 10

Thirrja e mbledhjeve në kundërshtim me rregullin

Mbledhja e organit kolegjal është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët me të drejtë vote, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 11

Kuorumi

1. Mbledhja e organit kolegjal, është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 12

Votimi i detyrueshëm

Anëtarët e organit kolegjal, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë, përveç organeve të zgjedhura dhe kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Kryetari i organit kolegjal voton i fundit.

Neni 13

Forma e votimit

1. Vendimet merren me votim të hapur, përveç rasteve kur dispozitat ligjore parashikojnë ndryshe.

2. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë.

3. Ata anëtarë të organit kolegjal që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit.

Neni 14

Shumica e nevojshme për të marrë vendime

1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.

2. Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë do të përsëritet e njëjtë situata, vendimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen tjetër, në të cilën një shumicë e thjeshtë do të ishte e mjaftueshme.

Neni 15

Barazia e votave

1. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e kryetarit është vendimtare.

2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër do të kemi përsëri një barazi votash, atëherë do të kryhet votim i hapur, me përjashtim të rasteve të parashikura në pikën 2 të nenit 13.

Neni 16

Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

2. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretari.

3. Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

4. Vendimet jonormative të organeve kolegjiale hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.

Neni 17

Përfshirja në procesverbal e votave “kundër”

1. Anëtarët e organit kolegjial mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ai organ.

2. Anëtarët, të cilët kanë votuar kundër një vendimi dhe kanë kërkuar shënimin e këtij fakti në procesverbal, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përjashtohen nga çdo përgjegjësi që mund të rrjedhë nga ky vendim.

Në rastet kur vendimet do t'i dërgohen një organi më të lartë të administratës, këto vendime do të shoqërohen me deklaratimet e votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 18

Të gjitha ato organe kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike, të cilat funksionojnë mbi bazën e ligjeve të posaçme, do të vazhdojnë të funksionojnë mbi bazën e ligjeve ekzistuese për sa kohë që këto të fundit do të jenë në fuqi. Veprimtaria e organeve kolegjiale ekzistuese do t'i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji vetëm për ato çështje (aspekte) të cilat janë të parregullura nga ligje të posaçme.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2389, datë 7.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**